



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 20 tetor 2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Adem Grabovci, Hajdar Beqa, Naim Fetahu dhe Duda Balje.

Munguan: Besnik Bislimi, Bali Muharremaj dhe Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi në Komision, Arjeta Luli, praktikante dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: z. Avdullah Hoti- Ministër i Financave (MF), Kosum Aliu- MF, z. Mahir Yagcilar- Ministër i Administratës Publike (MAP), Skender Sallauka- MAP, Fitim Sadiku- MAP, Ibrahim Gylderren- ZAP, Vlora Mehmeti- ZAP, Bujar Bajraktari- ZAP, Ilir Abazi- ZAP, Qëndresa Mulaj- ZAP, Alexandra Fehlinger- GIZ, Sanije Berisha- OSBE, Fjolla Uka- KDI, Agim Dibrani- MEF dhe Besarta Jashari- praktikante- Zyra e Presidentit.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, zv. kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë 29.09.2015 dhe 06.10.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2014. Të ftuar Ministri i Financave z.Avdullah Hoti, Ministri i MAP- it z.Mahir Yagcilar dhe z.Artan Venhari zv.Auditor i Përgjithshëm;
4. Të ndryshme;

***Zv. Kryetari,** pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

***Zv. Kryetari-** konstatoi që aprovohet rendi i ditës pa ndryshime.*

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë 29.09.2015 dhe 06.10.2015

***Zv. Kryetari-** konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 29.09.2015 dhe 06.10.2015, pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2014

***Zv. Kryetari-** Opinioni i Auditorit për Raportin Vjetor të Qeverisë është një opinion i kualifikuar, i cili vë në pah çështjet: Shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe subvencione dhe transferet në vlerë prej 24,470,260€ ishin keq klasifikuar si investime kapitale. Prej tyre 15,669,042€ ishin të buxhetuara gabimisht nga MF, ndërsa pjesa tjetër ishin të buxhetuara gabimisht nga vet OB-të. Më tutje, MF në Pasqyrat Vjetore Financiare për Buxhetin e Kosovës kishte shpalosur kufirin e deficitit buxhetor. LMFPP përcakton kufirin e deficit buxhetor prej 2%*

të BPV-se së parashikuar. Megjithatë, rishikimi ynë ka nxjerr në pah se Qeveria e Kosovës kishte dërguar projektligjin e buxhetit për 2014 në Kuvendin e Kosovës me një deficit të përgjithshëm buxhetor prej 2.59%. Si i tillë, kufiri i deficit buxhetor ishte tejkaluar për 0.59%. Në fund të vitit 2014, deficitit aktual ishte 2,23% e BPV-se. Po ashtu, transaksionet ndërqeveritare nuk janë konsoliduar në PVF/BK duke rezultuar në mbivlerësim prej 4,335,251€. Shpenzimet për Paga dhe Mëditje janë rritur për 16%, ndërsa shpenzimet për Investime Kapitale janë zvogëluar për 22%. Ky fakt nuk ndihmon zhvillimin ekonomik të vendit. Për më tepër borxhet në nivel shtetëror nuk janë trajtuar me seriozitetin e duhur. Shqetësim mbetet shkalla e ulët e mbledhjes së të hyrave nga tatimet, kthimi i kredisë nga KEK-u dhe rritja e vazhdueshme e obligimeve të papaguara nga organizatat buxhetore (OB-të).

Çështjet tjera të konsolidimit në pasqyrat vjetore financiare:

Pagesat nga Palët e Treta- të gjitha pagesat nga palët e treta duhet të regjistrohen në SIMFK dhe ato të raportohen në PVF të BK-së. Për këtë, çdo marrëveshje e arritur në mes të OB-ve dhe donatorëve, qoftë për pagesat e drejtpërdrejta apo për pagesat nëpërmjet Thesarit, duhet paraprakisht të paraqitet në Thesar për regjistrim. Në disa raste OB-të nuk e kanë bërë këtë. Andaj, vlera e pagesave nga palët e treta (donacionet) të paraqitura në PVF/BK-se është e nënvlerësuar për rreth 4,500,000€. Në PVF/BK janë raportuar vetëm 2,288,000€ në krahasim me vlerën totale prej 6,895,614€ të raportuara në PVF individuale të OB-ve.

Transaksionet ndërqeveritare- nuk janë konsoliduar në PVF/BK duke rezultuar në mbivlerësim prej 4,335,251€. E njëjta gjë ka ndodhur edhe viteve paraprake. Thesari vazhdon të mos e kryej konsolidimin e transaksioneve ndërqeveritare sepse sipas tyre, kjo ruan konsistencën dhe krahasueshmërinë me informacionin e raportuar në vitet e mëparshme.

Klasifikimi i shpenzimeve- pagesa për Anëtarësim në IFN/Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në vlerë prej 717,000€ është regjistruar dhe raportuar në PVF/BK-se gabimisht në kategorinë mallra dhe shërbime. Më tutje, edhe në kodin ekonomik “Kapital Tjetër” janë regjistruar dhe raportuar gabimisht shpenzimet në vlerë prej 47,714,405€. Shpenzimet ishin për blerjet e kompjuterëve, zhvillimin e softuerëve, riparimin dhe renovimin e ndërtesave, mirëmbajtjen e rrugëve, furnizim me material shpenzues, furnizim me libra etj. Megjithatë në vitin 2015, kjo është marrë parasysh dhe Thesari ka bërë jo aktiv kodin Kapital tjetër.

Analiza e pasqyrave vjetore financiare- Pranimet e vitit 2014 në raport me 2013 janë rritur për 1.4%, por që ishin 12% më të vogla se ato të planifikuara. Rritja ishte si rezultat i rritjes së të hyrave tatimore, financimit nga huamarrja si dhe rritja e të hyrave vetanake. Përderisa, të hyrat doganore për vitin 2014 ishin realizuar 93,3% e planit. Të hyrat e planifikuara nga ATK ishin realizuar 82% e planit dhe se shqetësim i ATK-së vazhdon të mbetet shkalla e lartë e borxheve të pa-inkasueshme, të cilat në fund të vitit 2014, ishin 277,823,490€. Në raport me 2013 kishte një rritje prej 24,326,786€ apo 10%. Sfidë tjetër ndaj kësaj do jetë vendimi i Qeverisë dhe ligji i radhës për faljen e borxheve.

Obligimet e papaguara- Obligimet e papaguara të OB-ve në fund të 2014 janë 165,387,912€. Prej tyre 148,200,865€ i takojnë nivelit qendror dhe 17,157,439€ nivelit lokal. Kjo vlerë është bartur për pagesë në 2015. Krahasuar me 2013, obligimet janë rritur për 111,731,584€. Rritja e obligimeve krahasuar me 2013, ishte rezultat i rritjes së obligimeve në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Obligimet e papaguara për MMPH për 2014 janë 114,390,183€. Prej tyre, 113,802,657€ janë obligime të cilat kanë rezultuar nga Vendimet e Qeverisë për Shpronësim për vitet 2010-2014. Ndërsa, pjesa tjetër prej 587,526€ ishin fatura të papaguara nga MMPH për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe investime kapitale.

Adresimi i rekomandimeve të dhëna në vitet e mëparshme:

Shqetësuese është niveli i ulët i implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Në raportin Vjetor të Auditimit për Pasqyrat e konsoliduara të Qeverisë së Kosovës për vitin 2013, AP kishte dhënë 48 rekomandime për Qeverinë, 15 për Kuvendin, 3 për kryetaret e komunave dhe 3 për Kuvendet Komunale. Nuk është parë ndonjë iniciativë për përgatitjen e ndonjë plan veprimi për adresimin e rekomandimeve të RVA-se nga ana e Qeverisë, dhe si rrjedhojë implementimi i këtyre rekomandimeve nuk ishte në nivelin e pritur. Vetëm shtatë prej tyre janë implementuar plotësisht. Si pasojë e kësaj disa nga rekomandimet janë përsëritur edhe këtë vit.

Nga krahasimet e bëra bazuar në të dhënat e dy viteve paraprake, shihet se ka një rritje në numër të rekomandimeve të adresuara nga ana e Qeverisë, por nëse bëhet një krahasim në përqindje, shihet se rekomandimet e adresuara në vitin 2012 janë 33%, derisa ato në vitin 2013 janë 32%.

Implementim i rekomandimeve vazhdon të jetë sfidë e vështirë për organizatat e nivelit qendror dhe lokal/komunat. Rekomandimet e pa adresuara kanë të bëjnë kryesisht me fushat si: saktësia e shpalosjeve në PVF, planifikimi dhe realizimi i buxhetit, menaxhimi i të hyrave, procedurat e prokurimit, klasifikimi i shpenzimeve, subvencionet, obligimet e papaguara dhe menaxhimi i regjistrave të pasurisë. Mos adresimi i rekomandimeve të dhëna ka rezultuar në dobësi të vazhdueshme në kontrollin e brendshëm dhe në humbje financiare, që ka bërë që disa nga rekomandimet të përsëriten.

Hajdar Beqa- Në kuadër të Qeverisjes së Mirë, Auditori i Përgjithshëm flet për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Auditimin e Brendshëm dhe Indikatorët e Performancës nëpër Komuna. Në kuadër të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, shumica e OB-ve nuk kanë udhëzime të brendshme apo procedura operative të detajuara që mbulojnë aktivitetet e përditshme të ndërlidhura me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Raportimet e dobëta menaxheriale, pamundësojnë vendim-marrjen dhe reagimin me kohë të menxhmentit në adresimin e dobësive dhe përmirësimet e nevojshme. Sfidë e OB-ve edhe më tutje vazhdon të jetë menaxhimi i rrezikut, kjo si një komponent kyç e MFK-së. Ndonëse ka filluar të kuptohet roli dhe rëndësia e vet-vlerësimit të organizatës nga menaxhmenti, ky obligim ligjor nuk është përmbushur nga të gjitha OB-të, e sidomos nga niveli komunal. Në kuadër të Auditimit të Brendshëm, ende ka organizata buxhetore të cilat nuk kanë të themeluar njësinë e auditimit të brendshëm. Planet e auditimit të disa NjAB-ve, nuk ishin të drejtuara sa duhet kah adresimi i rreziqeve, ishin më shumë të përqendruara në pajtueshmëri, e më pak ndaj ndryshimeve dhe përmirësimeve të sistemit. Mangësi tjera të cilat karakterizojnë punën e NjAB në disa komuna, kanë të bëjnë me mospërputhjet e aktiviteteve me planin e punës dhe përfundimisht kualitet i dobët i raporteve të auditimit.

Komiteti i Auditimit (KA), është organ që përkrahë pavarësinë e NjAB-ve derisa: rreth 20% e KA në nivelin qendror nuk janë efektive, në një ministri dhe në pesëmbëdhjetë komuna, KA nuk është themeluar ende, ndërsa në gjashtë të tjera ndonëse i themeluar është jofunksional, aty ku KA janë funksionale efekti i aktivitetit të tyre është i diskutueshëm, pasi që nuk i kryejnë detyrat e tyre ashtu siç kërkohet si dhe në shumicën e rasteve, anëtarët e KA nuk kanë përvojën dhe kualifikimet e nevojshme profesionale në fushën e financave dhe auditimit.

Sfidë kryesore mbetet zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.

Në kuadër të indikatorëve të performancës nëpër komuna, fokus i krahasimeve ishin: realizimi i buxhetit për investime kapitale, të hyrat, shpenzimet e reprezentacionit dhe derivateve, shqyrtimi i aplikacioneve për leje ndërtimi si dhe fusha e arsimit dhe shëndetësisë. Konkluzionet ishin si vijon: Në të gjitha fushat e indikatorëve janë vërejtur variacione të konsiderueshme, madje edhe në komunat me madhësi të përafërt, komunat kanë tendencë që të shfrytëzojnë maksimalisht fondet nga granti qeveritar, derisa pjesë e konsiderueshme e të hyrave vetanake barten në vitet vijuese, planifikimi i të hyrave vetanake bëhet pa mbështetje në analiza të trendëve dhe potencialit të mirëfilltë për gjenerimin e të hyrave. Shpesh herë kjo rezulton me tejkalim të planit inkasues. Shqetësuese është hyrja në obligime financiare dhe bartjes së tyre ndër vite, sidomos te komunat: Shtërpçë, Kllokot, Gjakovë, Gjilan dhe Lipjan. Detyrimet e përgjithshme financiare të të gjitha komunave në fund të vitit ishin 13,271,569€. Një fakt tjetër shqetësues, ishte edhe shpenzimi i madh për dreka zyrtare në disa komuna.

Tek sistemi i shërbimit civil, ishin vërejtur këto mangësi: Mos respektimi i kriterëve të konkursit publik gjatë rekrutimit të stafit, avancimi në karriera pa procedura të avancimit, pagesën e pagave shtesë pa aprovim paraprak dhe pa dëshmi përkatëse për punë shtesë, pozita të mbajtura nga ushtrues detyre përtej afatit kohor ligjor dhe mos azhurnimi i dosjeve të personelit.

Synavere Rysha- Prokurimi publik ka shënuar një progres të kufizuar, me mangësi të përsëritura edhe këtë vit në të gjitha fazat e tij dhe përmirësimi i sistemit të prokurimit, vazhdon të jetë sfidë për Qeverinë/ Kuvendin e Kosovës edhe në të ardhmen. Pasur parasysh se 488 milionë euro, apo rreth 33% të shpenzimeve të Buxhetit të Kosovës bëhet përmes prokurimit, kjo tregon ndikimin e madh që do të kishte mbarëvajtja efektive e këtij procesi. Mos përgatitja e mirë e procesit të prokurimit, dobësitë në zhvillimin e procesit si dhe mangësitë në menaxhimin e kontratave, janë tregues se prokurimi në OB kërkon adresim të problemeve të identifikuara dhe përmirësim në mbarëvajtjen e këtij procesi. Të gjeturat kryesore në nivelin qendror janë: planifikim i dobët i prokurimit, mangësi në përgatitjen e dosjes së tenderit, gjatë ekzekutimit të pagesave kishte shmangie apo devijime nga procedurat e thesarit, ndarje e tenderëve me qëllim të shmangies së procedurave të hapura të prokurimit, dobësi në vlerësimin e tenderëve, vonesë në realizimin e

projekteve dhe mangësi në udhëheqjen e procedurave të prokurimit me rastin e bashkëfinancimeve.

Të gjeturat kryesore në nivelin lokal janë: vlerësim i dobët i nevojave dhe përgatitje e dobët e paramasave dhe parallogarite, mungesë e planeve të prokurimit (komunat e Kosovës Veriore), planifikimi dhe menaxhimi i dobët i prokurimit dhe praktika e lidhjes së kontratave në fund të vitit, mungesë e projekteve para fillimit të procedurave të prokurimit për ekzekutim të punëve dhe mungesë e planeve për menaxhimin e kontratave, hyrja në kontrata jashtë planit të prokurimit si dhe pa procedura të prokurimit, lidhja e kontratave me çmime jo normalisht të ulëta, apo me çmime të larta krahasuar me vlerën e tregut, ndarje e tenderëve me qëllim të shmangies së procedurave të hapura të prokurimit, vonesa në ekzekutimin e punëve dhe mungesë e aplikimit të ndëshkimeve, anashkalimi i kriterëve të dosjes së tenderit, përshtatje e kriterëve të tenderit duke favorizuar operatorë të caktuar dhe pagesa pa përfundim të punëve dhe me situacione të paqarta.

Të gjeturat kryesore tek institucionet e pavarura janë: planifikimi i dobët i prokurimit, lidhja e kontratave pa zotim të plotë të mjetëve, procesimi i Urdhërblereve pas pranimit të faturës, dobësi në proceset e pranimit të mallrave dhe shërbimeve dhe lidhja e kontratave me çmime jo normalisht të ulëta.

Zv. Kryetari- i jep fjalën përfaqësuesve të Auditorit të Përgjithshëm.

Ibrahim Gylderan- për mendimin tonë, sfida tjetër është edhe numri i madh i autoriteteve kontraktuese, në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit, diku janë rreth 174 autoritete kontraktuese dhe ka raste ku një numër i tyre veprojnë brenda organizatës së njëjtë buxhetore. Çështje tjetër është edhe numri i madh i institucioneve të pavarura, rreth 30, ku prej tyre vetëm institucionet kushtetuese dhe disa të tjera do të duheshin të ishin të pavarura dhe të raportonin drejtpërdrejt te Kuvendi. Pastaj numri i madh i agjencive ekzekutive të ministrive, mbi 50, ku ndërlidhja e tyre përfshin përgjegjësin, llogaridhënien, raportimin, të gjitha këto nuk janë të qarta sa duhet. Po ashtu një çështje është mos përfshirja e Bankës Qendrore të Kosovës në kuadër të strukturës aktuale të llogaridhënies, konkretisht sipas ligjit të BQK- së, ZAP- i nuk ka të drejtë të bëjë auditimin e tyre, po ashtu është përjashtuar edhe aplikimi i ligjit të prokurimit publik dhe disa ligje tjera. Gjithashtu e fundit jo pak e rëndësishme, është edhe mungesa e kryeshefit ekzekutiv

në komuna. Ne kemi bërë rekomandime të cilat kryesisht janë për Qeverinë, që të respektohen klasifikimet buxhetore dhe të respektohet kufiri i deficitit buxhetor, të sigurohet konsolidimi i transaksioneve ndërqeveritare si dhe përmirësimi i procesit të regjistrimit të pagesave nga palët e treta, pastaj Qeveria duhet të udhëheq dhe të koordinojë një plan veprues për adresimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm dhe të raportoje për progresin e arritur, më tutje të themelohet një mekanizëm i cili do të analizonte shkaqet e rritjes së obligimeve të papaguara nga viti në vit, me qëllim që obligimet të zvogëlohen në një nivel të pranueshëm, futjen në funksion të një menaxheri apo kryeshefi ekzekutiv në komuna si nëpunës më i lartë civil, përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve të përditshme dhe shërbime për qytetarët. Në fushën e shërbimit civil kemi rekomanduar, që reformat në shërbimin civil në funksionalizimin e sistemit të ri të pagave të përmbushën në afat sa më të shkurtër, të shtohet niveli i kontrollit dhe i transparencës në procedurat e rekrutimit dhe pagesës së kompensimeve shtesë, pastaj Qeveria të ndërmarrë veprime konkrete në adresimin e mangësive në menaxhimin e pasurisë, programi e-pasuria të implementohet në të gjitha institucionet, të zbatohet një proces efektiv i menaxhimit të automjeteve në të gjitha organizatat buxhetore, duke siguruar monitorim të vazhdueshëm dhe veprim me kohë ndaj barrierave që pengojnë zbatimin e kërkesave ligjore, më tutje përmes agjencisë qendrore të prokurimit, e kemi rekomanduar Qeverinë të vazhdojë zhvillimin e prokurimeve qendrore për artikuj të konsumit të përbashkët për të përfitur nga ekonomia e shkallës si dhe të arrijë implementimin e sistemit të e-prokurimit me kohë, Qeveria të sigurojë që rekomandimet e auditorit të përgjithshëm për vitin aktual dhe ato paraprake në fushën e prokurimit të adresohen plotësisht, duke vendosur kontrole efektive gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe duke siguruar blerës në para.

Zv. Kryetari- i jep fjalën ministrit të financave z.Avdullah Hoti.

Avdullah Hoti- deri tani ne kemi aprovuar strategjinë për kontrollin e brendshëm të financave publike, që është diskutuar gjerësisht edhe me partnerët tonë ndërkombëtar që na mbështesin në MF, rekomandimet që kanë dalë prej kësaj strategjie e cila është aprovuar në Qeveri me 15 prill të këtij viti, ju kanë shpërndarë OB dhe kanë filluar të ndërmerren veprimet e nevojshme, ato që u përmendën këtu në Komision, sa i përket Komiteteve të auditimit të brendshëm, numrit të auditorëve, janë çertifikuar më shumë auditorë sesa që kanë qenë, janë 36 auditorë, 3 që janë

çertifikuar deri tani, është rishikuar pakoja e ligjeve fiskale, e cila do t'i përmirësoj edhe financat publike edhe për tu siguruar që nuk e mbyllim vitin me deficit edhe me obligime sikurse që është mbyll viti 2014, sepse po menaxhohen më mirë. Është rishikuar ligji i financave publike për të adresuar disa çështje që u ngritën këtu, ligji është në Komisionin për Buxhet dhe Financa, që besoj se shpejt do të trajtohen aty dhe do të shkoj në Kuvend. Është aprovuar në Qeveri ligji i prokurimit publik, që i adreson shumicën e çështjeve që u ngritën këtu, kemi bërë reformë të thellë sa i përket kësaj çështje dhe kemi siguruar që të gjitha agjencitë që kanë më pak se 50 punëtor, prokurimet për to ti kryej Qeveria ose Kuvendi, varësisht se në cilin autoritet janë këto agjencione. Të njëjtën gjë edhe për prokurimin elektronik, po bëjmë progres të mirë, i kemi përzgjedhur disa organizata ku sistemi testohet gjatë këtij viti, planet tona janë që bashkë me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, prej 1 janarit të vitit të ardhshëm, të fillojmë me aplikim të plotë të prokurimeve elektronike, mbi 700 milion euro që prokurohen nga ana e Qeverisë në investime kapitale dhe në mallra dhe shërbime. Kemi bërë progres në Reformat e Administratës Publike, Ministri i Administratës Publike e ka finalizuar draftin në konsultim me gjithë akterët dhe mendoj që shumë shpejt do të shqyrtohet në Qeveri dhe do të vjen në Kuvend, ku është një reformë e plotë e 80,000 personave, pagave për 80,000 personave që paguhen nga sektori publik, për tu siguruar që njerëzit paguhen njësoj për punë të njëjtë. Është aprovuar gjithashtu ligji për auditorin e përgjithshëm, jemi duke punuar në ligjin për raportim financiar dhe kontabilitet dhe shpejt besoj që do e dorëzojmë në Qeveri dhe do të vjen në Kuvend. Është avancuar sistemi i menaxhimit të financave dhe kontrollit përmes ngritjes së versionit 6.4 në versionin 7 në Thesar, që mundëson një kontroll shumë më të mirë të shpenzimeve në të gjitha OB, jemi duke i trajtuar shumë më mirë obligimet pa mbulesë, unë jam i vetëdijshëm që këtu ka pasur një rritje eksponenciale të borxheve prej vitit në vit, duke filluar prej 28 milion që kanë qenë në 2012, 46 milion në 2013 dhe 163 milion në 2014, këtë vit asnjë borxh i ri nuk është krijuar pa mbulesë. Jam i vetëdijshëm për klasifikimin joadekuat të shpenzimeve nëpër OB të ndryshme, sa i përket pagave dhe mallrave por edhe të kapitalet, i kemi zhvilluar kodet përkatëse për secilin projekt dhe kategori. Sa i përket prokurimeve të centralizuara, ju njoftoj që për herë të parë javën që shkoj unë kam nënshkruar dy kontrata të prokurimit të centralizuar. Po pres se në fund të nëntorit dhe në fillim të dhjetorit, të kem edhe një mision nga FMN, i cili do merret me vlerësimin efiçencës së investimeve kapitale që bën Qeveria, për tu siguruar që investimet kapitale që propozohen për OB, të shkojnë në ato projekte që kanë normë më të lartë të kthimit.

Zv. Kryetari- unë e kam një interesim, ju thatë se nuk keni lejuar që të keni obligime të pambuluara dhe e dyta është shlyera e borxheve të vjetra në 2008, pyetja është a i keni shlyer këto borxhe.

Avdullah Hoti- po ju informoj që ligji që është aprovuar në Kuvend, ka hyrë në fuqi me datë 2 shtator, në javën e tretë të shtatorit kryeministri ka nënshkruar UA për këtë ligj, i cili qartëson me detaje procedurat dhe borxhet të cilat falen, për të qartësuar edhe njëherë, falen borxhet e bizneseve dhe individëve ndaj administratës tatimore dhe ndaj doganave, falen borxhet e individëve dhe të bizneseve në tatimin në pronë, falen të gjitha borxhet e individëve dhe bizneseve për të gjitha shërbimet publike. Të gjitha OB, ndërmarrjet publike, komunat, ministritë që preken nga ky ligj, duhet që prej një afati 1 muaj, prej momentit që ligji hyn në fuqi, të publikohen listat e borxhlinjve dhe pas një muaji të fillojnë pagesën e tyre, ose pagesën e drejtpërdrejtë, në këtë rast nëse kryhen pagesat 2009-2014, ose të bëjnë marrëveshje deri në 3 vjet për kryerjen e obligimeve. Unë kam themeluar në bazë të UA me autorizim të Kryeministrit, Komisionin për Mbikëqyrje të Procesit, i cili ka 7-8 anëtarë prej ministrive dhe organizatave tjera buxhetore, që në baza mujore do të raportojnë tek unë për dinamikën e këtij procesi.

Duda Balje- unë gjatë leximit të raportit, vërejta se në disa raste ka pasur dobësi në menaxhimin e buxhetit, pyetja ime ka të bëjë me transaksionet ndërqeveritare, unë personalisht kam pasur një përvojë jo të mirë me këto evidenca, dikur para 5 viteve. Çka është ndërmarrë nga Departamenti i Thesarit për të evituar këto dobësi të cilat janë të paraqitura edhe në Raport Vjetor të Auditimit?

Kosum Aliu- çështja e transaksioneve ndërqeveritare, është një çështje që është përcjellur për disa vite, mirëpo këtë vit me rekomandimin e Ministrit të Thesarit, janë ndërmarrë masa që më aktin e dorëzimit të pasqyrave financiare, nuk do të pranohen PF, derisa të mos bëhet barazimi apo harmonizimi i transaksioneve ndërqeveritare. Këto ndodhin kryesisht në këto relacionet e ministrive kur lindin disa kërkesa.

Zv. Kryetari- i jep fjalën ministrit të Administratës Publike z.Mahir Yagcilar.

Mahir Yagcilar- sa i përket shërbimit civil, ne jemi në fazën përfundimtare dhe proces ndryshimit të ligjit, është edhe një rekomandim nga mandati i kaluar, nga Komisioni për Administratë Publike, që duhet të bëhen disa ndryshime, gjithashtu ligji i Shërbimit Civil është ndërlidhur edhe me ligjin e Administratës Shtetërore, por edhe aprovimi i ligjit për procedura të përgjithshme administrative. Në jemi në fazën ku duhet të përfundojmë dhe të analizojmë sistemin e ri të pagave. Sa i përket shtesave, ne inicuum një procedurë në Qeveri, që të gjitha shtesat të rishikohen në të gjitha nivelet. Gjithashtu jemi në bashkëpunim të ngushtë sidomos këtë vit, sa i përket menaxhimit të konkurseve dhe përfshirjen në listë të pagave në sistemin e pagave, divizioni i pagave tani është në MF, ndërsa në MAP po mbetet vetëm pjesa e menaxhimit të burimeve njerëzore. Te menaxhimi i pasurisë, ka një përmirësim të gjendjes, gjithashtu menaxhimi i automjeteve zyrtare, fatkeqësisht në këtë fushë nuk kemi gjetur një mënyrë të japim rezultate dhe raportimet mungojnë nëpër institucione dhe nuk është krijuar një mekanizëm zbatues për të gjitha institucionet. Te menaxhimi i teknologjisë informative, viti 2013, ndoshta edhe viti 2014, ka pasur një zhvillim edhe me aprovimin e Agjencionit të Shoqërisë së Informacionit, por me shkurtesa buxhetore për vitin 2015, ndërsa për vitin e ardhshëm kam dyshime që mundemi të ofrojmë diçka më shumë.

Zv. Kryetari- në ministrinë e juaj kemi vërejtur një progres në sistemin e e-pasurisë, por mendoj që kemi edhe shumëçka tjetër që duhet të bëjmë. Çështja e dytë që na jep optimizëm është çështja e pagave, gjithashtu çështja tjetër është edhe përdorimi i automjeteve, e cila është sfidë e madhe dhe duhet që edhe gjatë këtij viti të vazhdohet të punohet. Një çështje që do të doja që gjithashtu ti kushtonit rëndësi është edhe pagat dhe mëditjet, si duket ekziston një UA që nuk përkon me realitetin, është mirë të shikohen mëditjet, sepse ka shumë padrejtësi dhe duhet të trajtohen ato. Megjithatë ka përmirësim, ju do ti merrni rekomandimet dhe presim adresimin e tyre.

Naim Fetahu- kisha dashur të ndalem te çështja e prokurimit, unë e di se është punuar në këtë drejtim por nuk e di se deri ku është arritur, kur mendohet se projekti do të nis të zbatohet në ministri për herë të parë, ndërsa sa i përket çështjes së menaxhimit të automjeteve, nuk kisha dashur ti fajësojë ministrinë, sepse nuk kanë pasur mjete dhe gjithashtu ne i kemi cunguar me buxhet.

Synavere Rysha- ministër mua më intereson çështja e pozitive të mbajtura me ushtrues detyre përtej afatit kohor ligjor, dihet se ligji e përcakton që sa kanë të drejt UD të jenë të tillë, 3 muaj plus 3 muaj pra 6 muaj, por ka raste se në institucionet tona UD janë edhe më gjatë. Si dhe mosrespektimi i kriterëve të konkursit publik gjatë rekrutimit të stafit. Pse po ndodh kjo në institucionet tona.

Hajdar Beqa- unë pata një pyetje për ministrin, a ka bërë MAP- i ndonjë plan për trajnimin e zyrtarëve për zyrtarë të pasurisë për përdorimin e projektit të e-pasurisë. Gjithashtu a janë marrë në konsideratë rekomandimet e ZAP- it dhe a janë formuar grupet punuese për rishikimin e legjislacionit sekondar. Si e shpjegoni faktin se OB planifikojnë buxhet të njëjtë nga viti në vit, kur dihet se nevojat nuk janë të njëjta. Kjo vlen edhe për financat të cilat janë shkaktar që po ndikojnë në mosrealizimin e buxhetit sipas planit. Cilët janë faktorët me ndikim në mos inkasimin e duhur të të hyrave dhe cili është plani i rritjes së shkallës së inkasimit.

Mahir Yagcilar- ekziston një progres te e-pasuria, janë realizuar trajnimet, nuk mendoj që ka ndonjë problem, më shumë ka qenë hezitimi të përdorimi, por edhe kjo mendoj që tashmë është e tejkaluar. Pagat dhe shtesa është rritur dhe në asnjë ligj nuk mendohet të shkurtohen pagat, përkundrazi në shërbimin civil mendohet të bëhet edhe klasifikimi, ku do të bëhet rritje e pagave për disa pozita, por disa lloje të shtesave janë bërë me vendime të para 10-15 viteve dhe ende po vazhdojnë, qëllimi i propozimit të vendimit për shtesa ka qenë që të rishikohen të gjitha shtesat. Te përdorimi i automjeteve, ende ekzistojnë probleme, por tash edhe me Prokurimin Qendror, mendohet që në të ardhmen servisimi të bëhet përmes Agjencionit të Prokurimit. Sa i përket mëditjeve, ende është rregullorja e vjetër, por bashkë me Ministrin e Financave do të ishte mirë që të bëjmë një rishikim të rregullores sa i përket mëditjeve. Sa i përket prokurimit, Komisioni Rregullativ i Prokurimit janë në fazën përfundimtare sa i përket projektit të e-prokurimit përmes Bankës Botërore, ne e ndihmuam në aspektin e teknologjisë informative edhe për përcaktimin e kriterëve. Pritet që këta dy muaj të përfundohet projekti me aktet nënligjore të nevojshme, që viti i ardhshëm të jetë fillimi i zbatimit. Do të fillohet me institucionet qendrore dhe pastaj të vazhdohet në të gjitha institucionet. Mangësi te menaxhimi i automjeteve është se GPS janë instaluar por institucione i kanë kontrolluar vet, kështu që ky është një problem që duhet ta mendojmë ta zgjidhim në të ardhmen. Te legjislacioni sekondar besojmë që janë duke u rishikuar shumë legjislacione, e sidomos këto projektet e reja si e-prokurimi dhe çështje tjera. Sa i përket

pozitive të mbajtura me UD, sipas ligjit nuk lejohet më shumë se tre muaj, por në shumicën e rasteve procedura nuk përfundon brenda tre muajve, bëhet shpallja e konkursit për 15 ditë, deri sa të bëhet zgjidhja vazhdohet edhe 15 ditë, nëse ndodh një ankesë zgjat një muaj, nëse ankesa bëhet në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil vazhdohet edhe dy muaj, prandaj kjo nuk është në përputhje kur është hartuar ligji, nëse merren parasysh të gjitha këto bëhen pesë muaj.

Naim Fetahu- desha të bëjë një pyetje për të dy ministritë, në kuadër të MAP- it, është departamenti për regjistrimin e OJQ- ve dhe kemi një numër të madh të tyre që funksionojnë në Kosovë, mendoj që administrata publike e ka një kapacitet të vogël të stafit të vet për t'i kontrolluar këto OJQ dhe në të njëjtën kohë në kuadër të OJQ- ve, në kuadër të disa drejtorive regjistrohen edhe institucionet mikrofinanciare, a është rritë niveli i kontrollit të MF në këtë drejtim. Gjithashtu më intereson edhe çështja e integritetit të IT- së, në mes të MF dhe administratës tatimore, doganave dhe në çfarë periudhe kohore mendohet të realizohet ky projekt.

Hajdar Beqa- kisha një reagim të pozitave me UD, kemi raste në ministri përkatëse që janë edhe nga dy vjet, mendoj që shumë faktorë ndikojnë që UD të jenë më gjatë se sa e thotë ligji tre apo gjashtë muaj, një faktor është edhe neglizhenca e menaxhmentëve përkatëse në ministri përkatëse, faktorë tjetër është se hartimi i kriterëve duhet të jetë në harmonizim me ligjin për shërbyes civil, duke u nisur edhe prej pyetjeve që duhet të bëhen, duhet të jenë pyetjet standard, sepse në të kundërtën e rrëzon Këshilli, por në të njëjtën kohë duhet të jetë edhe kandidati që i plotëson kriteret, ne më shumë kemi të bëjmë këtu ndoshta në ministri përkatëse, se është gjetur kandidati, por nuk i plotëson kriteret, atëherë Këshilli ta rrëzon edhe gjashtë muaj të tjerë nëse ka ankesë, ai duhet të ketë pesë vjet përvojë pune, prandaj është mirë të rritet kontrolli në burime njerëzore.

Zv. Kryetari- krejt në fund do të doja ta prekim edhe fushën e auditimit të brendshëm, në veçanti punën e Komitetëve të Auditimit dhe një çështje tjetër rialokimit të institucioneve qeveritare në ndërtesa qeveritare, në kuptimin që ti ikim qerasë. Sa jeni duke punuar në këtë drejtim, sa keni paraparë mjete për këtë vit.

Mahir Yagcilar- sa i përket OJQ- ve, është ligji i cili sa na jep kompetenca aq jemi duke monitoruar, jemi duke monitoruar në aspektin e organizimit dhe çështjeve ligjore sa i përket personit kontaktues, Kuvendit, Këshillit Drejtues, ndërsa në çështjet tjera mikrofinanciare dhe OJQ- ve, ne nuk kemi kompetencë. Sistemi i integritetit të teknologjive informative, ne jemi duke u munduar të krijojmë një bashkëpunim në mënyrë që sa ma shumë sisteme të jenë të ndërlidhura njëri me tjetrin. Akomodimi i institucioneve është një sfidë tjetër dhe ne jemi duke u munduar që në këto çështje të cilat i kemi ti realizojmë, kemi bërë zgjidhje për Ministrinë e Diasporës, për Inteligjencën Financiare, tani jemi duke bërë disa zgjidhje për ATK- në në Prishtinë. Ne kemi disa projekte në fushën e arsimit, si Universiteti i Mitrovicës, janë disa ndërtime në sistemin e drejtësisë, çështjet tjera janë sa i përket buxhetit, mirëmbajtja e ndërtesave ekzistuese.

Zv. Kryetari- i jep fjalën përfaqësuesit të Ministrisë së Financave z.Agim Dibrani.

Agim Dibrani- ne kemi hartuar një plan veprimi, se cilët hapa do të merren për adresimin e këtyre çështjeve. Problemi i parë të çështja e auditimit të brendshëm, është mungesa e stafit të mjaftueshëm të auditorëve në OB me theks të veçantë në nivele komunale. Ne e kemi bërë një skemë, secila OB sa duhet të ketë auditorë të brendshëm, e cila do ti plotësoj kriteret për funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm dhe kemi marrë për bazë ligjin e auditimit të brendshëm dhe UA, i cili i përcakton kriteret në këtë fushë. Çështja e dytë, është krijimi i një njësie të përbashkët të auditorëve për auditimin e agjencioneve të pavarura që janë në kuadër të Kuvendit të Kosovës. Ne i kemi dhënë propozimet tona, e para është që disa auditorë që punojnë në këto agjencione, që veç i kanë njësitë e auditimit me një auditorë, mund ta marrin atë auditorë prej aty dhe ta bartin në kuadër të selisë së Kuvendit dhe pastaj kjo njësi e auditimit do të shërbejë si njësi e përbashkët auditimi në të gjitha agjencionet. Sa i përket çështjes së Komiteteve të Auditimit, është menduar që çështja e këtyre komiteteve të jetë më afër OB për të ndihmuar menaxhmentin në përmirësimin e kontrolleve të brendshme. Në çështjen e integritetit të sistemit të teknologjisë informative, ne sot kemi disa sisteme të teknologjisë informative, kemi PIP, SIMFK, e- pasurinë, edhe tek ne është një Komision duke punuar për integrimin e këtyre sistemeve, në mënyrë që të forcohen kontrollet e brendshme. Te rishikimi i rregullores për meditje, është një rregullore e kahershme e cila ka nevojë të rishikohet. Te çështja se cilat janë arsyet në ekzekutimin e buxhetit në 3 mujorin e fundit, realisht një planifikim më i mirë i buxhetit do të pengonte që situata të vinte deri këtu.

Fitim Sadiku- ne në Agjencionin e Organeve të Shoqërisë së Informacionit kemi pasur reduktim 100% të buxhetit, e kemi një kontratë për mirëmbajtjen e sistemit të gjendjes civile, ku Ministria e Punëve të Brendshme thotë se në asnjë rast nuk guxon të ndërprehet mirëmbajtja dhe ne kemi zero buxhet për atë projekt, kjo është e lidhur drejtpërdrejt me liberalizim të vizave.

Zv. Kryetari, meqenëse Raporti Vjetor i Auditimit ka 8 kapituj dhe në këtë takim u shqyrtuan vetëm 4 prej tyre, vendosi që në mbledhjen e radhës të KMFP- së të shqyrtohen edhe 4 kapituj e tjerë dhe e mbylli mbledhjen me këtë përfundim.

Përfundim

KMFP në takimin e radhës së komisionit do të shqyrtojë edhe kapitujt e tjerë të Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2014.

4. Të ndryshme

Zv. Kryetari, theksoi se varësisht prej zhvillimeve në Kuvend, do të zhvillohen edhe takimet e KMFP- së për shqyrtimin e raporteve individuale të auditimit. Me këtë e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Besnik Bislimi